



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:156835

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05441890

C-IV.-21-0004

Ankuesi

A H, fshati P, Shtime.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, nr.55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.12 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI097-0418, i datës 09 shtator 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.22 shtator 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI097-0418, të datës 05 shtator 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 4,950.00€, nga NSH “Tregtia” (në likuidim). Ankuesi kërkoi nga gjykata që të merr parasysh kërkesën e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në N.SH “Tregtia”, e cila kërkesë i është refuzuar si e pavlefshme nga AKP. Po ashtu, ankuesi pohoi se kërkesën e ka paraqitur me 04 shkurt 2014, e që ka qenë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, në pajtim me nenin 37.7 të ligjit nr. 04/L-034. Si provë ankuesi ka dorëzuar, kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me dt.19 shtator 2020, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP pohoi se në bazë të arkivës së privatizimit, privatizimi i NTSH “Tregtia” u krye më 27 maj 2008 dhe se pas shqyrtimit të arkivës së NSH, (lista e pagave Qershor 2005 – Maj 2008), AL konstatoi se gjatë kësaj periudhe parashtruesi i kërkesës nuk ishte punonjës aktiv i NSH, sipas listës së pagave dhe evidencave të ndërmarrjes, parashtruesi nuk ka ofruar shërbime për periudhën e lartpërmendur deri në privatizimin e ndërmarrjes, andaj si rrjedhojë marrëdhënia e punës nuk iu ndërpre si rezultat i privatizimit të NSH-së.

Lidhur me këtë çështje me dt.23 shtator 2020, DHPGJS nxjerr aktvendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit duke vendosur që secila palë të i bartë shpenzimet procedurale, kurse, me aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I-20-0441 dt.14 janar 2021, lënda është kthyer në rishqyrtim tek shkalla e parë. Gjatë zhvillimit të procedurës në shkallë të dytë, ankuesi kishte bërë dorëzimin e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e librezës së punës.

Duke vepruar sipas aktvendimit dhe sugjerimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, kjo gjykatë është lëshuar në merita të ankesës dhe me dt.04 shkurt 2021 ka lëshuar një urdhër për ankuesin, me të cilin ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë me të cilat e dëshmon lartësinë e pagës mujore. Ankuesi me dt.12 shkurt 2021 ka bërë dorëzimin e një parashtrësë, të cilës i ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e vendimit të AL nr. GJI097-0418 dt.05 shtator 2014 si dhe të vendimit nr. GJI097-0418 dt.05 shtator 2014, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopjen e librezës së punës.

Për qartësimin sa më të mirë të gjendjes faktike, gjykata përmes një urdhri të lëshuar me dt.14 nëntor 2023 ka kërkuar nga e paditura që të bëjë dorëzimin e provave me të cilat dëshmohet lartësia e pagës së ankuesit. E paditura iu ka përgjigj të njëjtit me dt.24 nëntor 2023 duke sjellë kopjet e listave të pagave për punëtorët e NSH “Tregtia” për muajin janar 2006, shkurt 2006, mars 2006, prill 2006, maj 2006, qershor 2006, korrik 2006, maj 2007, qershor 2007, korrik 2007 gusht 2007, shtator 2007, tetor 2007, nëntor 2007, dhjetor 2007, janar 2008, shkurt 2008, mars 2008, prill 2008, maj 2008, qershor 2008, korrik 2008, gusht 2008, shtator 2008, tetor 2008, nëntor 2008, dhjetor 2008.

Gjykata përsëri përmes telefonit ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave me të cilat e dëshmon lartësinë e pagës mujore. I njëjti me dt.26 dhjetor 2023, përmes parashtrësës ka deklaruar se i njëjti gjendet në listën e pagave të ndërmarrjes gjegjësisht mban nr.55, si dhe ka bërë dorëzimin e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës si dhe Vërtetimin nr.23 dt.11.06.2003 me të cilin dëshmohet se ankuesi që nga kjo datë ka qenë punëtor i paangazhuar në N.T.Sh. “Tregtia” në Ferizaj dhe se i njëjti për çdo muaj merr asistencë sociale në shumën prej 25 €.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëshmipërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkrësat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë lartësinë e pagës. Ankuesi së bashku me ankesë dhe parashtrësën për plotësim ka dorëzuar: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Kopja e librezës së punës, Vërtetimin nr.23 dt.11.06.2003, por edhe pas tentimit të gjykatës përmes lëshimit të urdhërit që i njëjti të bëjë dorëzimin e listës së pagave me anë të së cilës do të bënte për gjykatën të besueshme se sa ka qenë lartësia e pagës që e ka përfituar ankuesi, ai nuk e bëri këtë. Ankuesi ka dështuar që të dorëzoi prova relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Gjykata për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, ka kërkuar nga e paditura që të bëjë dorëzimin e provave materiale me të cilat dëshmohet lartësia e pagës së ankuesit, siç është lista e pagave. E paditura i është përgjigjur gjykatës dhe ka sjellë kopjet e listave të pagave për

punëtorët e NSH “Tregtia” për muajin janar 2006, shkurt 2006, mars 2006, prill 2006, maj 2006, qershor 2006, korrik 2006, maj 2007, qershor 2007, korrik 2007 gusht 2007, shtator 2007, tetor 2007, nëntor 2007, dhjetor 2007, janar 2008, shkurt 2008, mars 2008, prill 2008, maj 2008, qershor 2008, korrik 2008, gusht 2008, shtator 2008, tetor 2008, nëntor 2008, dhjetor 2008. Pas administrimit dhe vlerësimit të këtyre listave, gjykata nuk arriti të gjej emrin e ankuesit në mesin e punëtorëve të NSH “Tregtia”. Ankuesi në parashtrësën e dt. 26 dhjetor 2023 ka deklaruar se gjendet në listën e pagave me nr.55, por se gjykata vërtetoi se i njëjti nuk gjendet në atë listë.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte lartësinë e pagës. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtare
Hajrie Shala